



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar – Mars 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Prizren, për periudhën kohore Janar-Mars 2024.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar - Mars 2024

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve dhe organizim të skemave piramidale

Prizren, 16 Janar 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve A.E., B.E., dhe T.B., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprat penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, dhe “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” nga neni 294, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, të pandehurit B.E., dhe A.E., nga koha e pa vërtetuar deri më datë 30.08.2023 rreth orës 14:00^{min}, në shtëpinë e tyre në fshatin Zhur dhe në qytetin e Prizrenit, pa autorizim shpërndajnë dhe ofrojnë për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik dhe atë të llojit “kokaina”, në atë mënyrë që narkotikun e siguruar përmes rrugëve ilegale e mbajnë në shtëpinë e tyre në fshatin Zhur nga ku fillojnë shitjen në sasi të vogla personave të ndryshëm në fshatin Zhur dhe në qytetin e Prizrenit. Gjatë aplikimit të masave të veçanta hetimore më datë 30.08.2023, i pandehuri A.E., derisa ishte duke drejtuar veturën e markës “Fiat Croma” në Prizren, arrestohet dhe nga i njëjti sekuestrohen dy (2) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë me peshë prej 2.55 gram, përderisa në të njëjtën kohë gjatë kontrollit në shtëpinë e të pandehurve janë gjetur dhe sekuestruar një peshore digjitale ngjyrë e zezë, dhe 45 (dyzetë e pesë) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë me peshë prej 23.04 gram, tri (3) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit kokainë me peshë prej 52.34 gram dhe një qese najloni në peshë prej 1.76 gram, të cilat substanca narkotike pas ekzaminimit dhe ekspertimit nga Laboratori i Agjencisë Kosovare për Forenzikë, rezultojnë të jenë të llojit kokainë, nga matjet neto me peshë të përgjithshme prej 65.76 gram.

Me këto veprime, të pandehurit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Ndërsa, i pandehuri T.B., me dashje ndihmon të pandehurit e lartëcekur në kryerjen e veprës penale, duke iu siguruar klientë të ndryshëm për blerje të narkotikut.

Po ashtu, të pandehurit B.E., dhe A.E., nga koha e pa vërtetuar në vitin 2021 deri më datë 30.08.2023, në vazhdimësi, në fshatin Zhur, Komuna e Prizrenit, në një lokal dhe përmes mjeteve elektronike, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, organizojnë lojëra të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, në atë mënyrë që të njëjtit në bashkëkryerje, në mënyrë të kundërligjshme dhe të fshehtë përmes telefonave mobil dhe kompjuterit që gjendej në lokalin e lartcekur, instalojnë llogari të ndryshme nga ëeb faqe të ndryshme për lojëra të fatit, nga të cilat ëeb faqe krijojnë llogari për klientë të ndryshëm, më pas në ato llogari u dërgojnë të holla klientëve për të zhvilluar lojëra të fatit dhe më pas këta të fundit paguajnë të hollat kesh për të pandehurit.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Po ashtu, prokurori ka propozuar që si mjete të kryerjes dhe dobi pasurore, të konfiskohen sendet të cilat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, të cilat janë sekuestruar përkohësisht, e që janë:

Një (1) Automjet Fiat Croma, ngjyrë hiri metalike;

Një (1) automjet Citroen C-Elysee, ngjyrë e bardhë;

Tre (3) telefona: Sony Xperia, IPHONE X dhe Samsung;

Kartëmonedha në vlerë prej 1140 Euro dhe 40 Franga Zvicerane;

Pesëdhjetë e një (51) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit Kokainë me peshë 79.69 gram;

Një (1) peshore digjitale ngjyrë e zezë;

Një (1) DVR.

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve

Prizren, 18 Janar 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve V.B., A.F., A.K., dhe E.K., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, të pandehurit V.B., A.F., A.K., dhe E.K., me datë 21.11.2023 rreth orës 13:30^{min} në fshatin Duhël - Komuna e Suharekës, pa autorizim kanë poseduar substanca narkotike me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, në atë mënyrë që gjatë kontrollit rutinor të policisë në kuadër të planit operativ “Siguria në shkolla 2023/2024”, e me rastin e kontrollit të automjetit Golf V, të cilin e drejtonte i pandehuri V.B, dhe pasagjerë ishin të pandehurit A.F., dhe A.K., të shoqëruar me qytetarin B.Sh., te i pandehuri A.F., janë gjetur pesë qese najloni me substancë narkotike të llojit “marihuana” me peshë të përgjithshme 7.29 gram dhe te i pandehuri A.K., një qese najloni me substancë narkotike të llojit “marihuana” me peshë të përgjithshme prej 3.69 gram, substanca këto të shpallura me ligj si narkotikë, e të cilët nga automjeti në fjalë i kanë ofruar për shitje këto substanca narkotike pa pasur autorizim nga organi kompetent.

Po ashtu, me datë 22.11.2023 rreth orës 14:20 ^{min.} në Suharekë, në një parking në afërsi të Gjimnazit të Suharekës (brenda perimetrit prej 350 metrash), pa autorizim kanë poseduar substanca narkotike me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, në atë mënyrë që gjatë kontrollit rutinor të policisë në kuadër të planit operativ “Siguria në shkolla 2023/2024”, e me rastin e kontrollit të automjetit Golf V, të cilin e drejtonte i pandehuri V.B., dhe pasagjerë ishin A.F., A.K., dhe E.K., te i pandehuri E.K. është gjetur një qese najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit “marihuana” me peshë të përgjithshme 1.74 gram, te i pandehuri A.F., është gjetur një letër e bardhë brenda saj substancë narkotike e llojit “marihuana” me peshë prej 1.21 gram dhe një grinder për grirjen e marihuanës, në brendësi të automjetit pas ulëses të pasagjerit në një hapësirë në pjesën e pasme janë gjetur 70 qese të vogla të zbrazëta të vendosura në një qese e të cilat shërbejnë për paketimin e substancës narkotike, ndërsa me

datën e njëjtë rreth orës 18:00 min. në fshatin Studenqan, gjatë kontrollit të shtëpisë së të pandehurit V.B., janë gjetur dhe janë sekuestruar:

Një (1) qese najloni e mbushur me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 31.32 gram;

Një (1) qese najloni me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 82.56 gram.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar - Mars 2024



Pensionohet administratori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Xhemajl Qelaj

Prizren, 19 Janar 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren, ka organizuar takim përshëndetës për administratorin Xhemajl Qelaj, i cili ka arritur moshën e pensionimit.

Në këtë takim, kryeprokurori Admir Shala, ka vlerësuar lartë kontributin e tashmë ish-administratorit Xhemajl Qelaj, dhënë në administratën e Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe njehërit i uroi pensionim të mbarë, shëndet dhe suksese në jetë.

Ndërkaq, administratori i pensionuar, Xhemajl Qelaj, ka falenderuar të gjithë punonjësit e Prokurorisë Themelore në Prizren për respektin, mbështjetjen dhe bashkëpunimin që ka pasur me të gjithë, gjatë periudhës së punës në sistemin prokurorial.

Në shenjë respekti për kontributin e dhënë në këtë prokurori, kryeprokurori Shala, ndau mirënjohje falenderimi për ish-administratorin Xhemajl Qelaj.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar – Mars 2024

Aktakuzë për keqpërdorim të pozitës zyrtare

Prizren, 24 Janar 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A.S., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në vazhdimësi ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 07.09.2021 në Dragash, në cilësinë e personit zyrtar – referent pranë Zyrës kadastrale të Drejtorisë për urbanizëm, kadastrë dhe mbrojtjen e mjedisit të Komunës së Dragashit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e këtij të fundit, vepron në kundërshtim me Ligjin për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, në atë mënyrë që ngastrat kadastrale: P-457, P-1478 dhe P-2138 të Zonës Kadastrale të fshatit Brezne – Komuna e Dragashit, me pronar ekzistues D.B., pa bazë juridike dhe procedurë të rregullt ligjore, të njëjtat i regjistron në emrin e qytetarit H.B., duke ia lëshuar të njëjtit certifikatën e pronësisë së datës 07.09.2021, e cila certifikatë është në kundërthënie të plotë me certifikatën e pronësisë së datës 14.08.2018 lëshuar nga po i njëjti autoritet, qytetarit – të dëmtuarit D.B.

Ndërsa, me datë 02.11.2021 jashtë çdo autorizimi lidhur me detyrën e tij zyrtare, përpilon Shpjegimin me shkrim për Gjykatën, të cilin e nënshkruan dhe e vulos me vulën zyrtare të autoritetit kadastral, madje pa e protokolluar fare të njëjtin, ia dërgon Gjykatës, në të cilin shpjegim i ka

paraqitur sqarimet – arsyet e tij se përse i ka regjistruar ngastrat e lartpërmendura kadastrale nga pronari ekzistues D.B., në personin tjetër H.B., me çka i shkakton dëm të dëmtuarit D.B., në vlerën e ngastrave kadastrale prej 250,000.00 euro.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.


AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN
Janar – Mars 2024

Aktakuzë për keqpërdorim të pozitës zyrtare

Prizren, 24 Janar 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A.S., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në vazhdimësi ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, me datë 07.09.2021 në Dragash, në cilësinë e personit zyrtar – referent pranë Zyrës kadastrale të Drejtorisë për urbanizëm, kadaster dhe mbrojtjen e mjedisit të Komunës së Dragashit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat e tij, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e këtij të fundit, vepron në kundërshtim me Ligjin për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, në atë mënyrë që ngastrat kadastrale: P-457, P-1478 dhe P-2138 të Zonës Kadastrale të fshatit Brezne – Komuna e Dragashit, me pronar ekzistues D.B., pa bazë juridike dhe procedurë të rregullt ligjore, të njëjtat i regjistron në emrin e qytetarit H.B., duke ia lëshuar të njëjtit certifikatën e pronësisë së datës 07.09.2021, e cila certifikatë është në kundërthënie të plotë me certifikatën e pronësisë së datës 14.08.2018 lëshuar nga po i njëjti autoritet, qytetarit – të dëmtuarit D.B.

Ndërsa, me datë 02.11.2021 jashtë çdo autorizimi lidhur me detyrën e tij zyrtare, përpilon Shpjegimin me shkrim për Gjykatën, të cilin e nënshkruan dhe e vulos me vulën zyrtare të autoritetit



kadastral, madje pa e protokolluar fare të njëjtin, ia dërgon Gjykatës, në të cilin shpjegim i ka paraqitur sqarimet - arsyet e tij se përse i ka regjistruar ngastrat e lartpërmendura kadastrale nga pronari ekzistues D.B., në personin tjetër H.B., me çka i shkakton dëm të dëmtuarit D.B., në vlerën e ngastrave kadastrale prej 250,000.00 euro.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Janar – Mars 2024



Kryeprokurori i Prizrenit takoi Ministren e Drejtësisë

Prizren, 25 Janar 2024 – Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Admir Shala, sot ka zhvilluar takim zyrtar me Ministren e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, me të cilën kanë diskutuar çështjet e interesit të përbashkët.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi fuqizimin e bashkëpunimit në aspektin e drejtësisë, në drejtim të luftimit të kriminalitetit. Kryeprokurori Shala, e njoftoi Ministren Haxhiu, për punët, sfidat dhe synimet e prokurorisë që ai e drejton. Gjatë këtij takimi z. Shala, ka prezantuar të arriturat e Prokurorisë së Prizrenit. Po ashtu, gjatë takimit u diskutua për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit të ri të prokurorisë.

Në këtë takim, në veçanti u diskutua për rastet e dhunës në familje si një ndër rastet më të ndijshme për trajtim, si dhe për Ligjin e ri për Parandalimin dhe Adresimin e dhunës në familje.

Në fund të takimit, palët u dakorduan për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në kuptim të adresimit dhe jetësimit të reformave në drejtësi.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar – Mars 2024

Aktakuzë kundër katër personave për posedim dhe shitblerje të narkotikëve

Prizren, 26 Janar 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit E.Sh., për shkak se ka kryer veprat penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, dhe “Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge” nga neni 271, si dhe të pandehurve: Z.K. F.Sh., dhe V.Z., për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 269, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri E.Sh., me datë 05.08.2023 rreth orës 21:40^{min}, në Prizren, në lokalit me inicialet “L.B”, i cili gjendet në perimetrin brenda 20 metrash, në afërsi të shkollës, pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, dhe, të njëjtën e shpërndan tek të tjerët, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të lokalit të sipërshtënëuar, në trupin e tij, janë gjetur 16 qese plastike me substancë të dyshuar narkotikë të llojit “kokainë”, ndërsa, në lokal gjatë kontrollit, janë gjetur 70 qese plastike të mbushura me substancë të dyshuar narkotikë të llojit “kokainë” në peshë neto prej 29.46 gram, një dozë e substancës së njëjtë në peshë prej 0.31 gram ia kishte shpërndarë dhe dorëzuar të pandehurit Z.K., e gjatë kontrollit të shtëpisë së tij në fshatin Hoqa e Qytetit, në dhomën e fjetjes është gjetur një

peshore digjitale, mjet i cili është përdorë për matjen e substancës narkotike dhe 4,050.00 euro që dyshohet se janë mjete të fituara nga shitja e substancave narkotike.

Me këtë, i njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” sipas KPRK-së.

Po ashtu, i pandehuri E.Sh., me datë 05.08.2023 në lokalin e sipërshënuar të cilin lokal ai e drejton, dhe përdoret si kafeteri për publikun, lejon dhe toleron përdorimin e narkotikëve në atë mënyrë që të pandehurve F.Sh., Z.K. dhe V.Z., në cilësinë e konsumatorëve, u lejon përdorimin e substancave narkotike si “marihuanë” dhe “kokainë”. Me këto veprime, i njëjti ka kryer veprën penale “Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge” sipas KPRK-së.

Ndërkaq, të pandehurit: F.Sh., Z.K., dhe V.Z., me datë 05.08.2023 rreth orës 21:40^{min}, derisa kanë qenë në cilësinë e konsumatorëve në lokalin “L.B” në Prizren, pa autorizim ka poseduar narkotikë në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e policisë, tek i pandehuri F.Sh., në trupin e tij policia ka gjetur gjysmë joint (cigare e përdorur marihuanë) e dyshuar për lëndë narkotike të llojit marihuanë, me peshë prej 0.12 gram.

Tek i pandehuri Z.K., policia në trupin e tij ka gjetur katër foli alumini, me sasi të dyshuar narkotikë të llojit “marihuanë”, me peshë neto prej 1.6 gram dhe një qese plastike me substancë narkotike të dyshuar kokainë, me peshë 0.31 gram. Ndërsa, tek i pandehuri V.Z., policia me rastin e kontrollit tek i njëjti ka gjetur mbetje të substancës narkotike të dyshuar për marihuanë, me peshë prej 0.26 gram, një peshore digjitale dhe një mulli së bashku me një paketim rizlla, mjete këto për përgatitjen e substancës narkotike për konsumim.

Me këto veprime, të njëjtit kanë kryer veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” sipas KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartëcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Aktakuzë për dhënie të ryshfetit

Prizren, 05 Shkurt 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit M.M., (shtetas i Shqipërisë), i cili gjendet në paraburgim nga data 25.01.2024, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Dhënia e ryshfetit” nga neni 422, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri M.M., me datë 25.01.2024, në ora 12:00 në pikë kalimin kufitar në Vermicë, në mënyrë të drejtpërdrejtë për vete i ofron ose i jep ndonjë dhuratë të paarsyeshme apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ky i fundit të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, në atë mënyrë që duke e ditur se është në stop-listën e autoriteteve të Republikës së Shqipërisë, afrohet tek kabina e zyrtarit policor të Kosovës, me ç’rast derisa ky i fundit ishte duke bërë kontrollimin e dokumenteve, i pandehuri ia vendos në tavolinën e tij të punës shumën e parave prej dhjetë euro (10 €). I njëjti, menjëherë është ndaluar nga ana policisë kufitare të Republikës së Kosovës.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Aktakuzë për shitblerje të narkotikëve

Prizren, 20 Shkurt 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit G.I., i cili gjendet në paraburgim për shkak të

dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas aktakuzës, i pandehuri G.I., me datë 01.12.2023 rreth orës 23:10^{min} në Pikë Kalimin Kufitar të Vërmicës, saktësisht në hyrje nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, pa autorizim dhe me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që i pandehuri pasi siguron narkotikun në një vend të panjohur në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet autobusit pronë e një prej kompanive turistike, e depërton narkotikun në Republikën e Kosovës, mirëpo në hyrje të kufirit, i njëjti autobus së bashku me pasagjerët selektohet për kontroll të detajuar në vijën e dytë të kontrollit, dhe gjatë kontrollimit të përbashkët në mes të zyrtarëve policor dhe atyre doganor, haset një çantë krahu në vendin ku vendosen valigjet e krahut në pjesën e bagazhit sipër në autobus, dhe sekuestrohet një qese najloni me substancë të dyshuar për narkotikë, e cila substancë narkotike pas ekzaminimit dhe ekspertimit nga Laboratori i Agjencisë Kosovare për Forenzikë, rezulton të jetë e llojit kanabis (marihuana), nga matjet neto me peshë të përgjithshme prej 655.97 gram.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, i pandehuri i lartëcekur për veprën penale për të cilën akuzohet të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Janar – Mars 2024

Ndalohet një person për keqpërdorim të pozitës zyrtare

Prizren, 05 Mars 2024 - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, me urdhër të prokurorit, ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orëve, të dyshuarin M.S., në cilësinë e zyrtarit të Gjendjes Civile në Komunën e Mamushës, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Dyshohet se i njëjti, duke shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare u ka mundësuar disa personave – shtetas të huaj turq, fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pa përfillur procedurat ligjore për fitimin e shtetësisë.

Prokuroria Themelore në Prizren, brenda afatit ligjor, për të njëjtin do të vazhdoj me procedura të tjera hetimore.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN Janar – Mars 2024

Nxënësit e shkollës “Mehmet Akif” vizituan Prokurorinë Themelore në Prizren



Prizren, 27 Mars 2024 - Në kuadër të takimeve me qytetarë, sot, Prokurorinë Themelore në Prizren e vizituan nxënësit e klasave të katërta të shkollës “Mehmet Akif” në Prizren. Nxënësit u mirëpritën nga dy prokuroret e Departamentit për të Mitur, znj. Sahide Sefa dhe znj. Merita Kurtishi - Gaka, të cilat i njoftuan nxënësit për

punën dhe funksionimin e prokurorisë dhe për mënyrën si trajtohen të miturit para institucioneve të drejtësisë.

Në pjesën e dytë të vizitës, nxënësit patën rastin të njoftohen nga afër me objektin e prokurorisë dhe të shohin se cilat janë shërbimet që i ofron prokuroria për qytetarët e Prizrenit.

Prokuroria Themelore në Prizren, mirëpret të gjitha vizitat me qëllim të informimit dhe edukimit të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme dhe të studentëve.

AKTIVITETET E PROKURORISË THEMELORE NË PRIZREN

Janar – Mars 2024


Njoftim për Media

Prizren, 29 Mars 2024 – Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, njofton opinionin publik, se pas një pune të gjatë hetimore, me urdhër të saj dhe në koordinim me Policinë e Kosovës, pas aplikimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, me datë 28.03.2024 ka arrestuar personat e dyshuar K.B., dhe E.Sh., nën dyshimin për kryerje të veprave penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 paragrafi 1 lidhur me nenin 31, si dhe “Mbatja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 paragrafi 1, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas zhvillimit të urdhër – kontrollit në shtëpitë dhe pjesët përcjellëse të tyre, pronë e të dyshuarve, K.B., E.Sh., dhe S.F., në shtëpinë e të dyshuarit E.Sh., policia ka gjetur dhe sekuestruar sasi të narkotikëve të llojit “Kokainë” me peshë rreth 500 gr. Ndërsa në lokalin e të pandehurit K.B., është gjetur dhe sekuestruar një (1) pistoletë e llojit “TT” dhe rreth pesëdhjetë (50) fishekë.

Me urdhër të prokurorit personat e dyshuar K.B., E.Sh., gjenden në ndalim 48 orësh, ndërsa i dyshuari S.F., gjendet në arrati.

Brenda afatit ligjor, Prokurori i Shtetit, ndaj të dyshuarve K.B., dhe E.Sh., do të parashtroj kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.



Ndërsa, për të dyshuarin S.F., prokuroria në bashkëpunim me policinë, janë duke kryer hetime intensive për kapjen e tij.